



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-015
Prishtinë, më 23 mars 2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 23 MARS 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Elmi Reçica, Teuta Sahatqija, Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Uran Ismaili dhe Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 9 mars 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 9 mars 2015

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 9 mars 2015.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i Kuvendit, para diskutimit për miratimin e agjendës për seancë plenare, i njoftoi anëtarët e Kryesisë se për miratimin e dy ligjeve për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare nevojiten të paktën 80 vota “për”, kurse për zgjedhjen e Avokati të Popullit nevojiten të paktën 61 vota “për”, andaj kërkoi nga shefat e grupeve parlamentare që ta sigurojnë praninë e deputetëve në seancë plenare.

Për rendin e ditës dhe për funksionimin e seancës plenare diskutuan: Albulena Haxhiu, Valdete Bajrami dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Më pas, Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 26 mars 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Projektin për Eficiencën e Energjisë dhe Energjinë e Ripërtëritshme,*
5. *Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin për reformën shëndetësore,*

6. *Shqyrtimi i raportit të auditimit të sistemeve të prokurimit në Sektorin shëndetësor,*
7. *Zgjedhja e Avokatit të Popullit,*
8. *Propozimi për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,*
9. *Kërkesa e Grupit Parlamentar të AAK-së për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar,*
10. *Debat parlamentar për Radiotelevizionin e Kosovës,*
11. *Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit të posaçëm për zgjedhjen e një gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.*

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave

1. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, për përgjegjësinë kushtetuese të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me themelimin e Gjykatës Speciale, të propozuar nga GP i Lëvizjes “Vetëvendosje”

Për pikën e lartshënuar diskutuan: Aida Dërguti, Xhavit Haliti, Elmi Reçica, Donika Kadaj-Bujupi, Albulena Haxhiu, Sabri Hamiti dhe Teuta Sahatqija, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me interpelancën e lartshënuar, vendosi që Seanca plenare e radhës për këtë çështje të mbahet më 27 mars 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, z. Isa Mustafa për përgjegjësinë kushtetuese të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me themelimin e Gjykatës Speciale, të propozuar nga GP “Vetëvendosje”.

2. Rekomandimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve për Avokat të Popullit

Për rekomandimin e lartshënuar diskutuan: Sabri Hamiti dhe Teuta Sahatqija, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e lartshënuar, këtë çështje e radhiti në rend të ditës për seancën plenare të radhës, që do të mbahet më 26 mars 2015.

3. Procedimi i nismës qytetare për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Për pikën e lartshënuar diskutoi Albulena Haxhiu, diskutimi i së cilës është dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikën e lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të propozuar nga nisma qytetare, t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si Komision FunkSIONal, që ta shqyrtojë projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

4. Kërkesa e deputetit Glauk Konjufca, mbështetur edhe nga gjashtë (6) deputetë të tjerë, për debat parlamentar lidhur me punën 100-ditëshe të kryeministrit Isa Mustafa dhe Programin Qeverisë

Për kërkesën e lartshënuar diskutuan: Donika Kadaj-Bujupi, Teuta Sahatqija, Albulena Haxhiu, Valdete Bajrami, Sabri Hamiti dhe Elmi Reçica, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

Kërkohet nga kryeministri Isa Mustafa që ta përgatisë një raport lidhur me punën 100-ditëshe të Qeverisë, para se Kuvendi të debatojë lidhur me këtë çështje, më 2 prill 2015.

5. Rekomandimi i Komisionit ad hoc për shpalljen e konkursit për anëtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil nga radhët e komunitetit serb

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Të shpallet konkursi për zgjedhjen e një (1) anëtari të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nga radha e komunitetit serb.

2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që, në bazë të dispozitave të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ta shpallë konkursin për një (1) anëtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nga radha e komunitetit serb.

6. Kërkesa e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për Radiotelevizionin e Kosovës

Për kërkesën e lartshënuar diskutuan: Donika Kadaj-Bujupi, Elmi Reçica, Teuta Sahatqija dhe Albulena Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, këtë çështje e radhiti në rend të ditës për seancën plenare të radhës, që do të mbahet më 26 mars 2015.

7. Kërkesa për aprovimin e shpenzimeve të delegacionit të Asamblesë Kombëtare të Francës, që do ta vizitojë Kosovën prej 30 mars deri me 3 prill 2015

Për kërkesën e lartshënuar diskutuan: Teuta Sahatqija, Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve me rastin e vizitës të delegacionit të Asamblesë Kombëtare të Francës në Kuvendin e Kosovës, prej 30 mars deri me 3 prill 2015.
2. Shpenzimet e akomodimit, ushqimit, drekave dhe darkave të shtruara për delegacionin e lartpërmendur, si dhe shpenzimet tjera të dala shtesë me këtë rast mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

* * *

Kryesia, gjithashtu, pasi diskutoi lidhur me propozimin për formimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës me Asamblenë Kombëtare të Francës, mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Grupi i Miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës me Asamblenë Kombëtare të Francës, me këtë përbërje:

1. Sabri Hamiti, kryetar,
2. Mexhide Mjaku-Topalli, zëvendëskryetare,
3. Glauk Konjufca, zëvendëskryetar,
4. Blerim Grainca, anëtar,
5. Teuta Sahatqija, anëtare,
6. Time Kadrijaj, anëtare,
7. Haxhi Shala, anëtar,
8. Kujtim Paçaku, anëtar.

II. Sekretari administrativ caktohet nga Drejtoria për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare.

8. Kërkesa e deputetes Shqipe Pantina lidhur me debatin e kërkuar për Radiotelevizionin e Kosovës

Për kërkesën e lartshënuar diskutoi Albulena Haxhiu, diskutimi i së cilës është dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, këtë çështje e radhiti në rend të ditës për seancën plenare të radhës, që do të mbahet më 26 mars 2015.

9. Njoftimi i Komisionit për Legjislacion për formimin e Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Komisioni për Legjislacion, në bazë të nenit 70 të Rregullores së Kuvendit, e njofton Kryesinë e Kuvendit lidhur me formimin dhe përbërjen e Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit.

10. Njoftimi i katër kryetarëve të komisioneve parlamentar për vizitën zyrtare të realizuar në Tiranë

Kryesia u njoftua për vizitën zyrtare të katër kryetarëve të komisioneve parlamentare, atij për Buxhet dhe Financa, për Integritet Evropian, për Zhvillim Ekonomik dhe për Mbikëqyrjen e Financave Publike, të realizuar në Tiranë prej 19-22 shkurt 2015.

11. Njoftimi i delegacionit të Kuvendit të Kosovës për vizitën zyrtare të realizuar në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës

Kryesia u njoftua për vizitën e delegacionit të Kuvendit të Kosovës për vizitën zyrtare të realizuar në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, prej 27-30 janar 2015.

Pika shtesë:

1. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit të posaçëm për zgjedhjen e një gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Për rekomandimin e lartshënuar diskutuan: Sabri Hamiti, Teuta Sahatqija dhe Albulena Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e lartshënuar, këtë çështje e radhiti në rend të ditës për seancën plenare të radhës, që do të mbahet më 26 mars 2015.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 13:00.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale